



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

Mehmet Butuc
Pronar
RTV Yeni Donem
Prizren

Vendimi LIC: 2009/03
Ref: 0902/0303/CIMC/II

VENDIM

Lidhur me kërkesën për bartjen të pronësisë së Radio dhe TV Yeni Donem, tek kandidati për pronarë të N.SH. Yeni Donem, z. Ali Çankaja

Faktet

1. Parashtruesi i kërkesës është, z. Mehmet Butuc është pronar i N.SH “Yeni Donem, në kuadër të së cilës vepron Radio dhe TV Yeni Donem në qytetin e Prizrenit. Subjekti transmetues ka pranuar licencën nga Komisioneri i Përkohshëm për Media për Radio dhe TV Yeni Donem ka pranuar licencën më 27 maj 2005.
2. Më 5 nëntor 2008, pronari i N.SH “Yeni Donem” z. Mehmet Butuc ka paraqitur një kërkesë në zyrën e KPM-së për bartjen në tërësi të pronësisë së licencave për Radio dhe TV në emër të z. Ali Çankaja i cili që nga data 1 nëntor 2008 ka ofruar dëshmi se jeton përkohësisht në Prizren. Gjithashtu, z. Çankaja ka paraqitur dëshmi nga Komuna e Prizrenit – Departamenti për Administratë të Përgjithshme dhe Personel se është në proces të rregullimit të dokumentacionit për nevoja personale.
3. Personi i propozuar për pronarë të N.SH “Yeni Donem”, respektivisht i Radio dhe TV Yeni Donem, ka paraqitur dëshmi rreth një plani të qartë rreth investimeve që planifikon të bëjë në Radio dhe TV Yeni Donem.

4. Arsyeja kryesore e kërkesës për ndryshim të pronësisë është gjendja e vështirë financiare me të cilën është duke u ballafaquar pronari aktual z. Mehmet Butuc në menaxhimin dhe financimin e Radio dhe TV Yeni Donemit.
5. Më 5 nëntor 2008, pronari i propozuar për pronësinë e Radio TV Yeni Donem, z. Çankaja ka deklaruar se, përveç ndryshimit të pronësisë, nuk do të ketë ndryshim në strukturën e programit apo çfarëdo ndryshimi që nuk është në përputhje me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së Radio dhe TV Yeni Donemit.
6. Kandidati i propozuar për pronar të Radio dhe TV Yeni Donem ka deklaruar se do të investojë teknologji të reja dhe si pjesë e zhvillimit të kompanisë parashih edhe ngritjen profesionale të stafit aktual por edhe inkuadrimit të profesionistëve të rinj për të qenë pjesë e Radio dhe TV Yeni Donem. Si dëshmi për ngritjen profesionale të gazetarëve, kandidati i propozuar për pronarë ka paraqitur në KPM një marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin AAB duke dërguar në Turqi një numër të konsiderueshëm të studentëve për trajnim në lëmin e gazetarisë.
7. Kandidati i propozuar për pronar të Radio dhe TV Yeni Donem ka deklaruar se do të rregullojë çështjen e bartjes së pronësisë dhe Certifikatën e Biznesit të N.SH. “Yeni Donem” varësisht nga vendimi i Këshillit të KPM-së.
8. Gjithashtu, kandidati i propozuar për pronar të Radio dhe TV Yeni Donem ka paraqitur dëshmi se ka të regjistruar biznes tjetër në pajtueshmëri ligjet e Republikës së Kosovës, përmes të cilin vepron në Prizren
9. Më 30 maj 2005, Komisioneri i Përkohshëm për Media ka lëshuar rregulloren mbi Kualifikimet për Marrjen e Licencës për Transmetim (Rregullorja 2005/01) në përgatitje të lëshimit të licencave të korigjuara për të gjitha subjektet transmetuese. Në të njëjtën kohë, Komisioneri i Përkohshëm për Media ka themeluar procedurat për ndryshim të licencës duke kërkuar që të gjitha ndryshimet e tilla të bazohen në një Vendim zyrtar i cili tregon se ndryshimet e tilla janë në interes të publikut.
10. Kandidati i propozuar për pronar të Radio dhe TV Yeni Donem ka vepruar sipas të gjitha procedurave të përcaktuara nga KPM për ndryshim të pronësisë dhe është në pajtueshmëri të plotë me Kualifikimet për Marrjen e Licencës së KPM-së.
5. Neni 29.4 i Ligjit të Komisionit të Pavarur për Media dhe Transmetim thekson se: *“Rregullat, kodet dhe procedurat e përcaktuara nga Komisioneri i Përkohshëm për media mbesin në fuqi derisa të ndryshohen, të zëvendësohen apo të anulohen nga Komisioni i përkohshëm për media në pajtim me këtë ligj”.*

Arsyetimi

11. Në bazë të Ligjit Nr. 02/L-15 është themeluar Komisioni i Pavarur për Media dhe Transmetim i cili është autoriteti i vetëm në territorin e Kosovës për rregullimin e Spektrit të Frekuencave të Transmetimit, për lëshimin e licencave dhe mbledhjen e taksave për licencë transmetimi.
12. Neni 11.1 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“për të ushtruar veprimtarinë e transmetimit në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon Komisioni i Pavarur për Media”*.
13. Neni 11.4 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“licencat nuk mundë të shfrytëzohen dhe bartën pa autorizim dhe pa aprovim paraprakë me shkrim nga KPM”*.
14. Neni 5.2 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“çdo ndryshim në pronësi që kap më shumë se 10% të aksioneve të interesave ose ato që ndikojnë shumë në kontrollin e të Licencuarit do të kërkohet paraprakisht autorizim me shkrim nga ana e KPM-së”*.
15. Neni 5.4 i Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“KPM-ja do të lejojë transferimin e licencës vetëm kur ajo sigurohet që individit ose organizata të cilët propozohen që t’u transferohet licenca plotësojnë standardet e KPM-së për t’u dhënë një licencë”*.
16. Prandaj, në pajtim me nenin 5.4 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, Këshilli i KPM-së konkludon se kandidatit të propozuar për pronar t’i transferohet licenca, i përmbush standardet e kualifikimit për licencë të KPM-së.
17. Arsyetimin për bartje të pronësisë nga ana e parashtruesit të kërkesës, KPM e pranon si të mjaftueshëm dhe në shërbim të interesit publik për të aprovuar kërkesën për bartje të pronësisë. Kandidati i propozuar për pronar jeton përkohësisht në republikën e Kosovës, ndërsa njëkohësisht është në proces të kompletimit të dokumenteve për të qenë qytetar i Republikës së Kosovës.

Vendim

20. Këshilli i KPM-së konkludon se ndryshimi i pronësisë së Radio dhe TV Yeni Donem nuk do të ndikojë në ndryshimin e formatit të programit dhe zonës së mbulimit.
21. Këshilli i KPM-së konkludon se kandidati për pronarë të ri të Radio dhe TV Yeni Donem është një investitor serioz në zhvillimin e këtyre subjekteve transmetuese dhe i njëjti ka njohuri profesionale në menaxhimin e Radio dhe TV stacionit.

22. Prandaj, Këshilli i KPM-së merr vendim që pronësia e Radio dhe TV Yeni Donem të bartet tek z. Ali Çankaja, i cili njëkohësisht do të jetë edhe pronarë i N.SH Yeni Donem, dhe licenca e Radio dhe TV Yeni Donemit të ndryshohet.

Lëshimi i Vendimit

23. Këshilli i KPM-së e lëshon këtë vendim

A Gra

Argjentina Grazhdani
Kryesuese e Këshillit të KPM-së

18/02/2009
datë

Vërtetim

Më këtë vërtetohet se Këshilli i KPM-së ka marrë këtë vendim në pajtueshmëri me rregulloret dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë, dhe në pajtueshmëri me rregullat e procedurës së KPM-së.

Naile Selimaj

Naile Selimaj Krasniqi
Shefe Ekzekutive

18.02.2009
datë